



Lajmet e rreme gjatë pandemisë COVID-19 dhe ndikimi i tyre

Që nga shfaqja e rasteve të para me COVID-19 e deri më tani, në të gjitha vendet, përveç sfidës së ballafaqimit me këtë infeksion shqetësim mbetet edhe ballafaqimi me lajmet e rreme rreth kësaj pandemie. Lajmet e rreme përkufizohen si “Informacione të pavërteta të cilat pretendohen të jenë lajme për të cilat autori e di se janë të pavërteta dhe i shpërndan me qëllim të influencës politike ose përfitimit financiar për vetën ose të tjerët”.¹ Mirëpo lajmet e rreme nuk shpërndahen domosdoshmërisht vetëm nga mediat, rrjetet sociale apo individët në mënyrë të qëllimshme, pasi mund të ndodhë që të shpërndahet një lajm i rremë pa e ditur nga shpërndarësi se është i tillë.

Që në fillim të pandemisë COVID-19, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara dhe liderët e lartë të OKB-së kishin tërhequr vëmendjen për sfidën nga “infodemia” ose dezinformatat rreth pandemisë COVID-19. Sipas Sekretariatit të Përgjithshëm, “me përhapjen e COVID-19, është nisur një cunami i keqinformimit, urretjes, skandaleve dhe frikësimit”.² Si rrjedhojë, është shtruar nevojë e formimit të strategjive nga ana e shteteve për të reduktuar përhapjen e lajmeve të rreme. Në shërbim të këtij qëllimi 132 shtete anëtare të OKB-së kanë nënshkruar një deklaratë rreth rreziqeve të “infodemisë” për coronavirusin dhe zotimin për luftim të saj. Dezinformatat për COVID-19 kanë filluar me ‘mitin e shërimit nga COVID-19’ duke treguar rreth kurës që duhet përdorur për t’u shëruar, p.sh: “dezinfektimi i trupit duke përdorur alkool, ngrënja e hudhrave parandalon infektimin me COVID-19, përdorimi i rrezeve Ultra Vjollcë e mbyt virusit”³ etj.

Përveç miteve rreth prejardhjes së COVID-19, me zbulimin e vaksinës anti-covid është formuar hapësirë edhe për përhapjen e lajmeve të rreme

1 Democracy Plus & Konrad Adenauer Stiftung “Lajmet e rreme, kërcënimi i demokracisë”, (2019). Mund të gjendet në: <https://dpl.us/acw>

2 United States Mission to the United Nations “Deklarata ndër – rajonale mbi ‘Infodeminë’ në kontekst të COVID-19 (2020). Mund të gjendet në <https://dpl.us/t02>

3 Organizata Botërore e Shëndetësisë “12 mitet rreth COVID-19”. Mund të gjendet në <https://dpl.us/kpo>

rreth efekteve anësore të vaksinës. Nga këto dezinformata nuk ka mbetur pa u prekur as Kosova. Disa nga komentet në faqen e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë: “mos gënjeni pasi me këtë vaksinë as veten tuaj nuk mund ta mbron”, “Vaksina shkatërron të ardhmen tuaj”, “Kush garanton që me i marrë nuk ka pasoja?”, etj. Përveç komenteve të këtij lloji, në rrjetin social facebook janë formuar grupe anti-vaksinë të cilat bëjnë thirrje për mos vaksinim. Një prej këtyre grupeve quhet ‘diskutime rreth vaksinës’. Shumica e profileve në këtë grup janë të rreme dhe nuk dihet qartë kush qëndron prapa tyre. Grupet e këtij lloji kanë anëtarësi prej rreth një mijë personave dhe, përveç videoeve dhe fotografive të cilat shpërndahe që tregojnë kinse vaksinimin me dhunë që u bëhet njerëzve në vende të ndryshme të botës, në këtë grup bëhet edhe thirrje për shmangien e informimit nga mediat, duke kërkuar alternativa tjera informatash. Një nga postimet: ‘merr 2 vaksina plus një trombozë falas’ ka 109 pëlqime, dhe 263 shpërndarje. Gjithashtu, në këtë grup ka edhe postime që pohojnë se vaksina anti-covid përmban virusin COVID-19, si dhe bën thirrje për pjesëtarët e grupit të cilët e kanë marrë vaksinën por kanë efekte anësore të mbështjellin dorën me folje alumini që të ndalin ‘valët e infiltruara’.



Një nga postimet: ‘merr 2 vaksina plus një trombozë falas’ ka

109 pëlqime, dhe

263 shpërndarje.



Sipas organizatës GeoPost – e cila merret me ndikimet e huaja në Ballkanin Perëndimor, ka njoftuar se nga propaganda ruse rreth dezinformimit të vaksinave anti covid-19 nuk ka mbetur pa u prekur as Kosova. Drejtori i saj Gynen Venhari, ka thënë se “burimi i shumicës së dezinformatave në lidhje me vaksinat vjen nga aparati propagandistik i qeverisë ruse, e cila kultivon dhe shfrytëzon të ashtuquajturit ‘idiotë të dobishëm’ të huaj kundër vaksinave, duke shkaktuar dëm të dukshëm për qytetarët e vendeve perëndimore”.⁴ Formimi i grupeve të këtij lloji siç u përmend më lart sipas Venharit ndodh për shkak të interesave të aktorëve shtetëror rus. Për të reduktuar mundësinë e formimit të këtyre grupeve, Facebook ka mbyllur një rrjet të dezinformimit që përhapte lajme të rreme ndaj vaksinave kundër COVID-19 me bazë në Rusi. Facebook e kishte etiketuar operacionin si një “Fabrikë e Dezinformimit”, që kërkon të legjitimitojë pretendimet e rreme ndaj vaksinave.

Përveç formimit të grupeve, në Kosovë tendencë për përhapje të dezinformatave kanë edhe mediat online, ku sipas një hulumtimi⁵ nga NDI, që nga marsi i vitit 2020 deri në shkurt të vitit 2021, 3,613 postime në mediat online kanë përmbajtje me informacione të çrregullta. Sipas këtij studimi, në Kosovë shumë teori konspirative janë shpërndarë përmes rrjeteve sociale në Kosovë gjatë kohës së pandemisë duke treguar ‘kurën’ e shërimit. Këto postime kanë arritur një klikueshmëri të lartë. P.sh. një artikull që tregonte përbërësin që duhet përdorur në trupin e njeriut për të larguar virusin COVID-19 ka pasur rreth 668,700 klikime dhe dy shpërndarje.⁶ Sipas këtij hulumtimi, gjatë vitit 2020 në rrjetin social Facebook një lajm që tregonte se testi PCR detekton vetëm infeksionin por jo edhe nga kush është shkaktuar, ishte shpërndarë 108 herë në këtë rrjet social, ndërsa 111,000 persona e kanë klikuar.⁷ Një tjetër lajm i rremë ishte shpërndarë në Facebook se personat e infektuar me COVID-19 ishin vendosur me forcë në dhoma të spitalit dhe janë vranë, ky postim është shpërndarë 890 herë, dhe 83,000 persona e kanë klikuar.⁸

Britja e dyshimeve rreth vaksinave dhe rënia pre e lajmeve të rreme vije si pasojë e mosinformimit të qytetarëve për rëndësinë e vaksinimit dhe, efekteve anësore të mundshme që mund të shkaktohen. Interesimi dhe kureshtja për të ditur më shumë rreth vaksinave i shtyn qytetarët që të besojnë çfarëdo lajme që shfaqen rreth kësaj teme, pa i filtruar nëse janë të vërteta apo jo. Pasojat nga këto lajme mund të jenë: shkaktimi i ankthit dhe stresit duke i vënë në mëdyshje për imunizim, e deri te bojkotimi total i vaksinës anti-covid, e që si rrjedhojë ka shpërndarjen e virusit dhe, shfaqjen gjithnjë e më shumë të varianteve të reja. Sipas hulumtuesve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë “rreth 800 persona kanë vdekur si pasojë e lajmeve të rreme rreth COVID-19”.⁹

4 Telegrafi.com “Rusia me grupe propaganduese⁸ në rrjete sociale kundër vaksinimit edhe në Kosovë”, (2021). Mund të gjendet në <https://dpl.us/1sz>

5 NDI “Monitorimi i informacioneve të çrregullta në Kosovë”, (2021). Mund të gjendet në <https://dpl.us/7q7>

6 Po aty.


7 Po aty.

8 Po aty.

9 Newsy “Si t’i identifikojmë lajme online rreth pandemisë”. (2021). Mund të gjendet në <https://dpl.us/fac>

Luftimi i lajmeve të rreme dhe informimi i drejtë i qytetarëve rreth pandemisë COVID-19 ka qenë njëra ndër prioritetet e Qeverisë Kurti 2. Në programin qeveritar thuhet se “Ministria e Shëndetësisë do të zhvillojë vazhdimisht strategji komunikuese për informimin sa më efektiv dhe konkret me qytetarët, e cila do të përkthehet në fushatë, jo vetëm për pandeminë COVID-19. Po ashtu, fushata do të ofrojë informimin e duhur, në funksion edhe të parandalimit të lajmeve të rreme rreth pandemisë, duke i kushtuar kujdes të veçantë shëndetit mendor”.¹⁰ Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, një fushatë e komunikimit është duke u përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë mbështetur nga **Japan International Cooperation Agency**”¹¹

Mirëpo, sfida kryesore mbetet shpërndarja e shpejtë e këtyre lajmeve dhe pamundësia e kontrollimit të tyre. Pasi që mundësia e filtrimit të lajmeve, të vërteta dhe të rreme është e ulët si nga ana e qytetarëve ashtu edhe nga ana e institucioneve shtetërore, si dhe kontrollimi i mediave rreth plasimit të lajmeve nuk është metodë demokratike, është e rëndësishme përdorimi i mekanizmave ligjor për sanksionimin e shpërndarjes së dezinformatave. Mekanizmat sanksionues të mediave janë **Komisioni i Pavarur i Mediave** (KPM) i rregulluar me ligj¹² si institucion i pavarur, mandati i të cilit buron nga Kuvendi i Kosovës dhe trajton shkeljet nga mediat tradicionale si TV dhe Radio. Mirëpo, pasi problemi me lajmet e rreme nuk lidhet me mediat tradicionale pasi këto lajme shkruhen dhe shpërndahen në rrjete sociale dhe në faqe të ndryshme të internetit, roli i KPM-së në këtë fushë është i kufizuar. Institucioni tjetër që shërben si mekanizëm i ankesave i cili shqyrton ankesat për shkelje të Kodit të Etikës së Mediave (përfshirë online) është **Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)**. KMSHK është një organ vetërregullues i krijuar për dhe nga media e shkruar. Sipas kodit të etikës së KMSHK-së “1. Gazetarët dhe redaktorët do ta respektojnë të vërtetën faktike dhe të drejtën e publikut që ta dijë të vërtetën. 2. “Gazetarët dhe redaktorët kanë obligim profesional që me kohë të korrigjojnë çfarëdo informacioni të publikuar për të cilin vërtetohet së është i pasaktë”.¹³ Në rast të shkeljes së këtyre parimeve, KMSHK jep mendim i cili është provë në gjykatë për trajtimin e rastit të shpifjes ose fyerjes. Në fillim të pandemisë, KMSHK ka bërë thirrje që gjatë raportimit rreth pandemisë mediat e shkruara të verifikojnë informacionet nga burimet zyrtare si dhe “Në rast të përhapjes së lajmeve të rreme KMSHK u bënë thirrje mediave që të publikojnë demante dhe materiale të cilat i denoncojnë si të pavërteta informacionet e rreme”.¹⁴



Mirëpo, sipas drejtorit të KMSHK-së – Imer Mushkolaj, gjatë vitit 2021 nuk ka pasur ankesa të qytetarëve rreth lajmeve të rreme. Sipas Mushkolaj-t “Në mungesë të ankesave të qytetarëve, KMSHK e ka të pamundur që të marrë masa ndaj përmbajtjeve të rrejshme, ndaj lajmeve të rrejshme, por edhe ndaj linqeve, profileve e ueb adresave të rrejshme”.¹⁵ Njëra ndër arsytet e mungesës së ankesave nga ana e qytetarëve është mos aftësia e dallimit të lajmeve të rreme dhe atyre të vërteta nga ana e qytetarëve. Për këtë arsye është e rëndësishme që Institucionet si: Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë konkretisht Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHPK) të formojnë manuale me anë të të cilave qytetarët informohen për dallimin mes lajmit të rremë dhe atij të vërtetë. Deri më tani nga këto institucione nuk është bërë mjaftueshëm në këtë aspekt, pasi nga ana e Ministrisë ka pasur vetëm informacione dhe fushata vetëdijësuese rreth vaksinimit, por jo edhe fushata rreth parandalimit dhe ‘imunizimit’ të qytetarëve nga lajmet e rreme. Në këtë drejtim rol të rëndësishëm kanë edhe mediat, si transmetuese të lajmeve dhe informacioneve, përgjegjësia në këtë aspekt bie konkretisht tek redaktorët e lajmeve të cilët duhet të sigurohen që lajmi të jetë i bazuar në fakte, dhe të mos lejojnë përhapjen e lajmeve të rreme dhe dezinformatave, posaçërisht në kohë pandemie.

10 Programi i qeverisë 2021-2025 (2021). Mund të gjendet në <https://dpl.us/wjs>

11 Takim me Faik Hoti, departamenti për komunikim në Ministrinë e Shëndetësisë, (15 tetor 2021).

12 Ligji nr. 04/L-044 mbi Komisionin e Pavarur për Media. (2012). Mund të gjendet në <https://dpl.us/xo6>

13 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) “Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës”, (2019). Mund të gjendet në <https://dpl.us/uyu>

14 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) “Rekomandime për mënyrën e raportimit në lidhje me COVID-19”, (2019).

Mund të gjendet në <https://dpl.us/pfd>

15 Kallxo.com “Asnjë ankesë për lajme të rrejshme në media, KMSHK inkurajon qytetarët të ankohen”, (2019). Mund të gjendet në <https://dpl.us/rm0>

Rekomandime:

- Ministria e Shëndetësisë duhet që në bashkëpunim me KMSHK-në, me mbështetjen e agjencive donatore, të dizajnojnë një fushatë komunikimi ku ndikimi i dezinformatave dhe lajmet e rreme në pandeminë COVID-19 të jenë në fokus të fushatës.
- Fushata duhet të ilustrojë rastet që tregojnë se si të dallohen lajmet e vërteta përballë lajmeve të rreme dhe të organizohen aktivitete që targetojnë të rinjtë për të parandaluar krijimin dhe shpërndarjen e dezinformatave dhe lajmeve të rreme për COVID-19. Ilustrimet, skenarët duhet të përdoren për t'i bindur më mirë qytetarët për vaksinim si dhe për t'u përgatitur kundër lajmeve të rreme dhe dezinformatave.
- Fushata duhet të jetë e targetuar, për shembull, të synojë të rinjtë, ose mediat, rajonin e caktuar, grupmoshën e caktuar dhe të japë mesazhet në përputhje me rrethanat. Për më tepër, fushatat përmes të cilave ofrohen mesazhe të përgjithshme për audiencën e përgjithshme duhet të kufizohen.
- Ministria e Shëndetësisë, KMSHK dhe Policia e Kosovës duhet të bashkëpunojnë ngushtë në identifikimin e lajmeve të rreme duke përfshirë burimet e lajmeve të rreme dhe të koordinojnë luftën kundër lajmeve të rreme dhe dezinformatave.
- KMSHK duhet të punojë vazhdimisht me mediat online për të parandaluar publikimin e dezinformatave dhe lajmeve të rreme nga artikujt e përkthyer nga mediat ndërkombëtare.
- Ministria e Shëndetësisë dhe KMSHK duhet të punojnë me Policinë e Kosovës për ta informuar këtë të fundit për rastet e lajmeve të rreme të krijuara apo të shpërndara nga llogaritë e rreme në Facebook. Policia e Kosovës më pas duhet t'i raportojë rastet e tilla në Facebook për të mbyllur llogaritë e tilla dhe për të hequr lajmet e rreme nga Facebook.
- Ministria e Shëndetësisë e mbështetur nga agjencitë donatore duhet të hartojë udhëzime për informimin e qytetarëve për lajmet e rreme gjatë pandemisë, duke zbutur efektin e tyre në procesin e vaksinimit.
- Edukimi dhe trajnimi online për lajmet e rreme duhet të vihen në dispozicion të qytetarëve. Një shembull i mirë mund të jetë platforma e D+ për lajmet e rreme për të mësuar më shumë rreth dallimit midis lajmeve të vërteta dhe të rreme. [fakeNews - Democracy Plus \(dplus.org\)](https://www.dplus.org/)

